

PHI LAN THR OPY

edicioni 4

hapësirë e dedikuar

për FILANTROPINË

#philanthropy

— kontakt :   



Rockefeller
Brothers Fund

Philanthropy for an Interdependent World

©PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

TIRANË, SHQIPËRI

Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Fondit Rockefeller Brothers. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondit Rockefeller Brothers.

PHI
LAN
THR
OPY

hapësirë e dedikuar

për FILANTROPINË

Në këtë edicion



5

Rreth revistës

7

Të dhëna rreth
aktivitetit filantropik

janar - qershor 2022

17

Rrathë Dhurues 2022

24

Smile.al

Shpallet thirrja e dytë për
OJF-të e interesuara

27

**Intervista me
përfaqësues të
nismave filantropike
në vend**

Arbi Mulhaxhia

32

**Fushata në ndihmë të
personave në nevojë**

35

Fondacionet Komunitare

37

**Kuadri mundësues
ligjor mbi aktivitetin
filantropik**

***Mirë se vini në edicionin e katërt të revistës
Philanthropy!***

Në këtë edicion, ju do të njiheni me nismat të ndërmarra në fushën e aktivitetit filantropik gjatë muajve janar – qershor 2022.

Një fokus të veçantë në këtë edicion zë diskutimi publik, lokal dhe rajonal mbi **krijimin e një mjedisi mundësues për aktivitetin filantropik** dhe lehtësirave tatimore, veçanërisht për adresimin e nevojave si pasojë e situatës pandemike përmes së cilës po kalojmë.

Në qershor të këtij viti u organizua ankandi i tretë i dhurimit live, "**Rrathë Dhurues 2022**". Ankandi bëri bashkë rreth 90 pjesëmarrës, individë, përfaqësues të sektorit të biznesit, komunitetit të donatorëve, institucioneve diplomatike, shoqërisë civile, medias etj., të cilët ofruan mbështetje financiare, materiale, dhe konsulencë falas për zbatimin e tre nismave të prezantuara. Shuma totale e mbledhur prej 2,100,000 Lekë e tejkaloi objektivin e vendosur prej 900,000 lekë në total, duke konfirmuar sërish ndjeshmërinë qytetare dhe solidaritetin ndaj komuniteteve në nevojë.

R
r
e
t
h
e
n
s
h



Shpallet **thirrja e dytë** për projekt propozime për organizatat jofitimprurëse në platformën Smile.al. Afati përfundimtar për të dërguar propozimet është data **10 tetor 2022**. Ndërkohë 5 iniciativa të reja komunitare janë shpallur në platformë dhe në këtë edicion do të gjeni një përshkrim të shkurtër mbi to.

Një seksion shumë i rëndësishëm i këtij edicioni janë të dhënat dhe faktet nga **monitorimi mujor i aktivitetit filantropik** në vend përmes medias dhe platformave online, të cilat ofrojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe të detajuar të panoramës filantropike në Shqipëri gjatë gjysmës së parë të vitit 2022.

Fushata të ndërmarra në ndihmë të grupeve në nevojë vijojnë të jenë në fokus të këtij edicioni. Koncerti “Ende ka shpresë”, organizuar nga studentët e “Fakultetit të Mjekësisë”, Universiteti i Tiranës, ishte një tjetër event i rëndësishëm në drejtim të mbështetjes së komuniteteve në nevojë. Tre fëmijëve të cilët vuajnë nga sëmundje hematologjike, përmes fondeve të mbledhura nga event, iu mundësua kujdesi i duhur shëndetësor. Në këtë edicion Z. Arbi Mulhaxhia, një ndër organizatorët e këtij event do të tregojë mbi “Medtalent” dhe arsyen për ndërmarrjen e kësaj nisme.

Partnerët Shqipëri vijon takimet me disa grupe informale dhe organizata jofitimprurëse duke i asistuar në funksionimin e tyre si **Fondacione Komunitare**. Gjatë këtyre muajve është ofruar asistencë në drejtim të mobilizimit të komunitetit e grupeve të interesit për të gjeneruar të ardhura.

Partnerët Shqipëri si pjesëmarrëse në një seri tryezash dhe takimesh rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare të organizuara nga rrjeti WINGS dhe ECFI ka promovuar zhvillimet më të fundit në vend dhe sfidat në lidhje me mjedisin mundësues mbi aktivitetin filantropik.

Nëse keni komente mbi artikujt e këtij edicioni apo jeni të interesuar për të qenë në edicionin e rradhës, ju lutem shkruani tek kkeruti@partnersalbania.org

Lexim të këndshëm!

T Ë D H Ë N A
R R E T H
A K T I V I T E T I T
F I L A N T R O P I K


J A N A R - Q E R S H O R 2 0 2 2

Të dhënat e mëposhtme pasqyrojnë aktivitetin filantropik në Shqipëri gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2022, bazuar në monitorimin ditor të mediave, përfshi ato sociale si dhe nga raportimet dhe publikimet e institucioneve publike dhe jo-publike.

Raporti analizon sektorët dhe çështjet kryesore që janë mbështetur, natyrën dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik si dhe natyrën e dhuruesve dhe përfituesve.

Nëpërmjet këtij monitorimi, Partnerët Shqipëri synon të rrisë vetëdijen publike mbi aktivitetin filantropik dhe të informojë të gjithë aktorët e përfshirë dhe të interesuar mbi impaktin dhe vlerën sociale të tij.

Numri i dhurimeve




- Monetare (60.37%)
- Mallra/Produkte (32.22%)
- Punë Vullnetare (4.07%)
- Miks (1.85%)
- Shërbime (1.48%)

Vlera sipas natyrës së dhurimit në Lekë


Mijë Lekë



Dhurime në grup



Dhurime individuale



Forma e dhurimit


Evente
52

270


Dhurime të drejtpërdrejta
56

Fushata për ngritjen e fondeve
162


Dhurime në grup




Dhurime individuale



Dhurime në grup




Dhurime individuale




Dhuruesit sipas Formës së dhurimit


- OJF
- Korporatë
- E panjohur
- NVM
- Individë
- Miks
- Grup dhuruesish



- Grup dhuruesish
- OJF
- Korporatë
- Individë
- E panjohur
- Miks
- NVM



- Korporatë
- OJF
- NVM
- Grup dhuruesish
- Miks
- Individë



*Dhuruesit llogariten vetëm një herë, pavarësisht nga numri i dhurimeve të kryera në secilën prej kategorive të "Formës së dhurimit".

Fushata për ngritjen e fondeve

91 Thirrje për Dhurime

15 Fushata përmes medias sociale & platformave Crowdfunding

47 Fushata përmes platformave Crowdfunding

7 Mega Fushata

2 Fushata përmes platformës Facebook për Impaktin Social*

Evente


51 Evente live

1 Evente Online

20,090 dhurues të gjurmuar përmes fushatave crowdfunding dhe platformës Facebook për Impaktin Social


*Platforma e dedikuar e Facebook për ngritje fondesh për kauza sociale.

Numri total i dhuruesve*



*Në kuadër të kësaj analize, dhuruesit llogariten vetëm një herë, pavarësisht nga numri i dhurimeve të kryera gjatë procesit të monitorimit.

Vlera sipas natyrës së dhuruesit



3 DHURUESIT KRYESOR sipas numrit të dhurimeve

- #1 Banka Credins
- #2 Grupi Balfin
- #3 Food Bank Shqipëri

3 DHURUESIT KRYESOR sipas vlerës së dhurimeve

#1 Grup dhuruesish 21,741,984 Lekë

Fushatë crowdfunding për të ndihmuar Omerin e vogël nga Kosova.

#2 Grup dhuruesish 18,432,920 Lekë


Fushata crowdfunding "Të shpëtojmë jetën e Lejlës dhe Kristit!" në ndihmë të dy fëmijëve në kushte të rënda shëndetësore.

#3 Grup dhuruesish 16,644,496 Lekë


Fushatë crowdfunding në ndihmë të fëmijëve pa përkujdesje prindërore në Shqipëri.

- Fëmijë dhe të rinj - Me aftësi të kufizuar (24.44%)
- Publik i Gjerë - Vështirësi ekonomike (14.07%)
- Fëmijë dhe të rinj - Pa përkujdesje prindërore (12.59%)
- Publik i Gjerë - Zonë specifike (5.93%)
- Miks (5.56%)
- Të Rritur - Të moshuar (5.19%)
- Tjetër (5.19%)
- Fëmijë dhe të rinj - Të talentuar (4.07%)
- Publik i Gjerë - Komunitet fetar (3.7%)
- Publik i Gjerë (3.33%)
- Të Rritur - Me aftësi të kufizuar (3.33%)
- Fëmijë dhe të rinj (2.96%)
- Fëmijë dhe të rinj - Zonë specifike (2.96%)
- Të Rritur - Të papunë (1.11%)
- Publik i Gjerë - Që jetojnë në vende të tjera (1.11%)
- Publik i Gjerë - Me aftësi të kufizuara (1.11%)
- Fëmijë dhe të rinj - Vështirësi ekonomike (0.74%)
- Fëmijë dhe të rinj - Komunitetet minoritare (0.74%)
- Gra dhe fëmijë - Viktima të dhunës dhe trafikimit (0.74%)
- Fëmijë dhe të rinj - Të pastrehë (0.37%)
- Publik i Gjerë - Komunitetet Minoritare (0.37%)
- Të Rritur - Të pastrehë (0.37%)


Përfituesit Përfundimtar





Shpërndarja Gjeografike e Përfituesve



Shpërndarja Gjeografike e Dhuruesve






Diaspora 3,0%



Shtetas të huaj 6,3%





Diaspora

Shtetas të huaj

Qëllimi i dhurimit


- Mbështetje e grupeve të marginalizuara (27%)
- Shëndetësi (19.3%)
- Zbutja e varfërisë (17.8%)
- Dhurime sezonale (7%)
- Edukim (6.7%)
- Art dhe kulturë (6.7%)
- Ruajtja dhe mbrojtja e mjedisit (4.4%)
- Sport (2.6%)
- Zhvillimi ekonomik (2.2%)
- Tjetër (1.9%)
- Infrastrukturë publike (1.1%)
- Aktivitete fetare (1.1%)

- Përgjigje ndaj fatkeqësisë natyrore (0.7%)
- Të drejtat e njeriut (0.7%)
- Mirëqenia e kafshëve (0.4%)
- Trashëgimi kulturore (0.4%)



Fjalorth

Kanalet e dhurimit



Dhurim i drejtpërdrejtë - Dhurimi që kryhet direkt nga dhuruesi tek përfituesi

Fushata për ngritjen e fondeve - Mbledhje e fondeve që ndodh gjatë një periudhe të caktuar kohe për një kauzë të caktuar sociale

Evente - Është një ngjarje që organizohet në kuadër të mbledhjes së fondeve për një kauzë të caktuar

Zbutja e Varfërisë - Dhurimet që janë kryer për zbutjen e varfërisë për individë apo familje që jetojnë në vështirësi ekonomike apo të prekur nga fatkeqësitë e mëparshme natyrore

Dhurime Sezonale - Dhurime që kryen gjatë sezonit të festave

Publik i Gjerë - Grupe njerëzish apo individë, të cilët janë ndihmuar nëpërmjet ndihmave ekonomike apo materiale në raste të fatkeqësive natyrore, apo vështirësive të jetesës

Grup dhuruesish - Grupe të mëdha ose të vogla individësh që dhurojnë

Miks - Dhurime të cilat kombinohen nga më shumë se një kategori / qytet

NVM - Ndërmarrje të vogla dhe të mesme

Platforma Crowdfunding (Individë apo familje) - dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga individë apo familje

Platforma Crowdfunding (OJF) - dhurimet që kanalizohen përmes platformave online crowdfunding, të krijuara nga OJF-të

Institucione Private - Biznese

R R A T H Ë D H U R U E S

1 6 Q E R S H O R 2 0 2 2

Në qershor 2022 u organizua event i tretë "Rrathë Dhurues".

Rrathë Dhurues është një event i dhurimeve live, i cili u jep individëve mundësinë të bashkohen rreth një qëllimi filantropik për të mbështetur iniciativa komunitare. Stimulimi i dhurimeve individuale dhe korporative për aktivitete të OShC-ve që synojnë një ndryshim social dhe një transformim pozitiv e të qëndrueshëm të komunitetit dhe mjedisit është qëllimi thelbësor i eventit.



#RrathëDhurues
Shqipëri

R R A T H Ë D H U R



Eventi i dhurimit live "Rrathë Dhurues 2022" bëri bashkë rreth 90 pjesëmarrës, individë dhe përfaqësues të sektorit të biznesit, komunitetit të donatorëve, institucioneve diplomatike, shoqërisë civile, medias etj., të cilët ofruan mbështetje financiare, materiale, dhe shërbime falas për zbatimin e tre nismave të prezantuara. Shuma totale e mbledhur prej 2,100,000 Lekë e tejkaloi objektivin e vendosur prej 900,000 Lekë në total, duke konfirmuar sërish ndjeshmërinë qytetare dhe solidaritetin ndaj komuniteteve në nevojë.

UES 2022



Fëmijë të shëndetshëm, komunitet i shëndetshëm!

'Fëmijë të shëndetshëm, komunitet i shëndetshëm' do të kontribuojë në përmirësimin e shëndetit dhe mirëqënies së 400 fëmijëve të Njesisë Administrative nr. 4, në Tiranë përmes ngritjes së një Shërbimi Dentar pranë Qendrës Komunitare "Gonxhe Bojaxhi".

Fëmijët janë nga familje vulnerabël, me vështirësi ekonomike, familje të rikthyera nga emigracioni, familje të dëmtuara nga tërmeti, komunitete romë dhe egjiptiane, ku shërbimi dentar përveçse se është një e drejtë e munguar, shihet nga prindërit, si një shërbim që është i pamundur t'ju ofrohet fëmijëve të tyre. Nga të dhënat e stafit të qendrës, rreth 90% e këtyre fëmijëve vuajnë nga sëmundje dentare dhe nuk tregojnë asnjë kujdes për higjienën orale. Ngritja dhe ofrimi i këtij shërbimi brenda ambienteve të Qendrës Komunitare do të mundësonte plotësimin e një të drejte themelore dhe të munguar për këta fëmijë. Organizata zbatuese është Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes.



Pop-up book!

"Pop-up book!" synon të kontribuojë në përmirësimin e aftësive social-edukative të fëmijëve dhe të rinjve në zonën rurale të Ferraj, Njësia Administrative Dajt, Tiranë, duke ofruar një mjedis miqësor zhvillues dhe inovator, nëpërmjet leximit. Investimi në krijimin e një hapësirë miqësore, letrare, zhvilluese dhe inovatore brenda ambienteve të shkollës

Ferraj do të jetë një nismë komunitare mjaft e dobishme për më shumë se 148 nxënësit e këtij komuniteti të cilët nuk kanë asnjë mundësi argëtimi, përveç ambienteve të shkollës të ndërtuar rreth viteve '60. Hapësira bashkohore në formën e një biblioteke, më tekste shkencore dhe libra artistike ndërthurur edhe me aktivitete të organizuara nga mësuesit e shkollës, psikologë dhe organizata të ndryshme apo vullnetarë do të krijonte një mjedis mundësues për fëmijët. Organizata zbatuese është Shoqata Kombëtare Edukim për Jetën-SHKEJ.



Nadja e mirë gjyshërit tanë!

Këndi i Studimit synon të mundësojë ambiente të përshtatshme studimi për fëmijë të cilët jetojnë në familje me kushte të pafavorshme ekonomike, në zonën e Tufinës në Tiranë. Për shkak të situatave problematike të mbivendosura të këtyre familjeve dhe nevojës për të siguruar ushqim, shkollimi i fëmijëve zhvendoset nga prioritetet bazike dhe si rrjedhim nxit mundësinë për mos ndjekje të rregullt të shkollës dhe në rastet më ekstreme në braktisjen e saj. Përmes kësaj nisme do të mbështeten 14 familje, të cilat kanë 3 deri në 5 fëmijë, me një kënd studimi në banesat e tyre dhe mjetet e duhura shkollore për fëmijët, duke mundësuar kështu kushtet bazë por të duhura ku fëmijët të përgatiten për lëndët mësimore. Gjithashtu një kënd studimi i përbashkët në ambientet e Qendrës Ura do të shërbejë për dhjetra fëmijë të tjerë në nevojë. Organizata zbatuese e iniciativës është "Qendra Tek Ura".





RTSH

The Funding Network
June 28 at 3:00 PM - 🌐

Did you know there are #crowdfunding events all over the world run by our network of international partners? 🌍

Last week, events in Germany and Albania each raised over 17,000 euros for change-making projects.

These projects included dental support for children in marginalised communities, the creation of a recreational space for the elderly, and the creation of a pop-up library.

Read more here 👉 <https://bit.ly/3OgcPDg>

#TFNInternational #GivingCircle #Philanthropy

EVENTI NË FOKUSIN E
MEDIAS



The Funding Network

smile.ai





S M I L E . A L

W W W . S M I L E . A L

Shpallet **thirrja e dytë** për projekt propozime për organizatat jofitimprurëse përmes platformës Smile.al. Platforma mundëson mbledhjen e fondeve online në mbështetje të nismave komunitare në fushat e shëndetit, solidaritetit, promovimit të trashëgimisë kulturore, mjedisit, sipërmarrjes sociale dhe inovative, edukimit dhe trajnimit, si dhe për veprimtaritë sportive. Thirrja është e hapur deri më **10 tetor 2022**. Ndërkohë njihuni me pesë iniciativat e reja të publikuara në platformë, të cilat kanë nevojë për mbështetjen tonë:

5 INICIATIVAT



Edhe unë jam një talent

Nisma synon advokimin dhe mbështetjen e fëmijëve me çrregullime të spektrit të autizmit dhe synon edukimin përmes vizatimit si një terapi për zhvillimin e aftësive psiko-sociale dhe integrimin dhe socializimin e këtyre fëmijëve me njëri – tjetrin. Për më shumë rreth nismës klikoni [këtu](#)



Boccia Albania

Kampionati i Boccia do të vijë si një pilotim i parë në qarkun e Elbasanit që në vitet në vazhdim të bëhet pjesë integrale e programeve të Ministries së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Ky kampionat synon të integrojë dhe të fuqizojë me aftësi të përqendrimit, prezicionit dhe të fokusimit të rinjtë me aftësi ndryshe. Për më shumë rreth nismës klikoni [këtu](#)



Mendo edhe për mua

Qëllimi i ndërhyrjes së propozuar është të forcojë më tej përgjegjësinë sociale dhe komunitare ndaj shtresave në nevojë. Mbështetja e cila propozohet të ofrohet për fëmijët të cilët i përkasin komuniteteve vulnerabël si Selitë dhe Yzberisht do të ofrojë krijimin e një mjedisi miqësor në mjediset e shkollës dhe më pas të qendrës ditore në afërsi të komunitetit të Selitës për të rritur ndjenjën e barazisë dhe reduktimin e diskriminimit kryesisht në mjedisin shkollor. Për më shumë rreth nismës klikoni [këtu](#)

E R E J A



Gratë dhe ekonomia e gjelbërt

Qëllimi i fushatës është promovimi i bashkëpunimit dhe pavarësisë ekonomike për gratë në zonën e Manzës, mbi sipërmarrjen e gjelbërt, si një mundësi punësimi, pavarësie ekonomike dhe menaxhimi miqësor të tokës. Gratë do të angazhohen në mbjelljen e rozmarinës organike, në një sipërfaqe prej 2 hektarësh. Për më shumë rreth nismës klikoni

[këtu](#)



Ofro terapinë e munguar

Sot terapitë për fëmije me nevoja të veçanta, kushtojnë. Prandaj, nisma konsiston në ofrimin e terapisë së zhvillimit për një vit, për 7 fëmijë të cilët nuk kanë mundësi për ta paguar atë. Për më shumë rreth nismës klikoni

[këtu](#)

I N T E R V I S T A
M E P Ë R F A Q Ë S U E S
T Ë N I S M A V E
F I L A N T R O P I K E N Ë
V E N D



S O L I D A R I T E T I P Ë R

F Ë M I J Ë T N Ë

N E V O J Ë

Arbi Mulhaxhia



Student i "Fakultetit të
Mjekësisë"
Anëtar i grupimit "MedTalent"

Ju lutem mund të na tregoni ku konsiston nisma juaj dhe arsyet/shtysa për të ndërmarrë një nismë të tillë?

Së pari, dua të theksoj se ne jemi një grup studentësh të Fakultetit të Mjekësisë, të cilët më datë 8 dhjetor 2021, "Ditën e Rinisë", formuam "MedTalent".

Qëllimi i "MedTalent" është të nxjerrë në pah talentet e studentëve të mjekësisë në fushat e muzikës, kërcimit, pikturës dhe fotografisë, sportit, librit dhe edukimit mjekësor. Deri më sot, jemi organizuar në gjashtë departamente ku zhvillohen aktivitete javore dhe deri më tani shumë studentë janë angazhuar në aktivitetet e organizuara nga MedTalent.

Organizimi i koncertit "Ende ka shpresë" ndodhi në kohën kur disa prej nesh po kryenim ciklin e praktikës në spitalin e Pediatriisë së Përgjithshme, pranë Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë. Duke diskutuar me njëri –tjetrin dëshironim të kryenim një aktivitet që të ishte gjithëpërfshirës duke nxjerrë në pah studentët e talentuar të fakultetit, dhe njëkohësisht të ishim në shërbim të humanitetit, si mjekë të ardhshëm. Kështu lindi "Ende ka shpresë"!

Cili është grupi i synuar, fushat dhe impakti i ndërhyrjeve?

Gjatë praktikës sonë, ndeshemi me familje të cilat marrin shërbime spitalore, por janë në kushte të vështira ekonomike. Gjatë muajit maj, në diskutim me shefen e pediatriisë Znj. Anila Gode dhe punonjësen sociale të spitalit bëmë një vlerësim të fëmijëve dhe familjeve të tyre që ishin në kushte më të vështira ekonomike. Kështu përzgjedhëm 3 fëmijë të cilët vuajnë nga sëmundje hematologjike, për t'iu gjendur pranë dhe mbështetur ata.

Koncerti “Ende ka shpresë” u ideua dhe u organizua brenda dy javëve të muajit maj. Për mendimin tim suksesi i këtij eventi ishte fryma e bashkëpunimit midis studentëve. Disa të rinj u angazhuan me organizimin e aktivitetit duke komunikuar edhe me këngëtarë dhe artistë, të cilët performuan vullnetarisht në koncert dhe mbështetën kauzën tonë. Disa studentë vullnetarisht performuan duke

aktruar, kënduar dhe interpretuar. Në hyrje të koncertit u ekspozuan punimet e studentëve me pikturat dhe fotografitë e tyre. Shuma e mbledhur nga biletat e shitura në koncert ishte afërsisht 138,000 Lekë, dhe secila familje u mbështet me një shumë prej 46,000 lekë.

Impakti që pati nisma jonë ka qenë shumëdimensional. Së pari, arritëm të mbështesim tre fëmijë dhe familjet e tyre duke u dhënë mbështetje dhe besim se në këtë rrugëtim ata nuk janë vetëm. Së dyti, arritëm të rrisim sensibilizimin e audiencës të pranishme në aktivitet mbi sëmundjet hematologjike, pasi në fillim të koncertit shfaqëm një video sensibilizuese mbi çfarë janë këto sëmundje, larg gjuhës dhe zhargonit mjekësor, për të qenë e kuptueshme nga të gjithë. Impakt tjetër është që u krijuam studentëve të mjekësisë një hapësirë për të shfaqur talentet e tyre përpara publikut. Të gjitha këto kontribuan në realizimin e ëndrrës sonë.

Nuk e prisnim, por shefja e pediatriisë Znj. Anila Gode, në emër të Drejtorisë së QSUT na akordoi "Certifikata Mirënjohjeje" dhe kjo është kënaqësia më e madhe që mposhti lodhjen dhe mundimin tonë për organizimin e këtij event.



MedTalent


ENDE
KA
SHPRESE




Cilat janë planet tuaja të ardhshme?

Planet tona për të ardhmen janë që “MedTalent” të pasurohet me aktivitete të ndryshme, duke trajtuar tematika të larmishme. Synojmë që në të ardhmen të organizojmë fushata mbi kauza sociale edhe për individë që preken nga sëmundje të ndryshme shëndetësore. Nisur nga impakti që pati koncerti dhe interesi i lartë i studentëve për t`u angazhuar, plani ynë është që koncerti “Ende ka shpresë”, të jetë i përvitshëm për të qenë më pranë njëri-tjetrit.

F U S H A T A



N Ë N D I H M Ë T Ë
P E R S O N A V E N Ë
N E V O J Ë



Fushata

disa nga fushatat e ngritura gjatë muajve janar - qershor 2022.

#1

Fondacioni Credins ka në fokus të punës së tij ndihmën e vazhdueshme për komunitetin shqiptar. Një nga fushat specifike ku Fondacioni është fokusuar, është dhe rritja e mirëqenies sociale për komunitetet dhe shtresat në nevojë. Fondacioni Credins ka bashkëpunuar me Institucionin Papa Xhovani XXIII, për të mbështetur familjet me të ardhura të ulëta, në rajonin e Shkodrës. Gjithashtu ka ofruar edhe pajisje të ndryshme si tavolina, karrige, etj., me objektivin për të ndryshuar dhe përmirësuar kushtet dhe infrastrukturën e këtij Institucioni dhe për të lehtësuar shërbimin ndaj qytetarëve.

#2

Diaspora kontribuon! Falë mbështetjes financiare të Z. Arben me vlerë 20,000 EUR, familja Haxhia në Shkodër ndërtoi nga themelet shtëpinë e saj të re.



Diaspora



Credins Dhuron

#3


Shoqata “Jetimi në Fokusin Tonë” së bashku me avokat Enea Cenko dhe noterin Klajdi Kaci ndihmuan familjet në nevojë përgjatë Muajit të Ramazanit.



#4


Në kuadër të ditës Ndërkombëtare të Librit, Shërbimi Social Shtetëror për të rinjtë e Shtëpisë-Familje në Shkodër organizoi diskutime me shkrimtarë lokal për të diskutuar mbi rëndësinë e librit. Përveç takimeve, ata kontribuan me dhurimin e librave duke pasuruar bibliotekën e Shtëpisë-Familje në Shkodër!

DITA NDËRKOMBËTARE E LIBRIT





F O N D A C I O N E T
K O M U N I T A R E

Partnerët Shqipëri po asiston një grup të ngushtë organizatash jofitimprurëse dhe grupesh informale, të cilat duan të punojnë si fondacione komunitare. Gjatë këtij gjashtë mujori asistenca u fokusua mbi identifikimin e çështjeve problematike në komunitet, hartimin e një plani mbi mobilizimin e komunitetit dhe grupeve të interesit në drejtim të gjenerimit të të ardhurave, që do të shërbejnë për adresimin e çështjeve komunitare.



Duke qenë një organizatë mbështetëse për fondacionet komunitare, Partnerët Shqipëri gjatë muajit prill, mori pjesë në tryezën e diskutimit të organizuar nga "Iniciativa Evropiane për Fondacionet Komunitare" (ECFI). Gjatë takimit u diskutua mbi një seri ndërhyrjesh të fondacioneve komunitare dhe organizatave mbështetëse të fondacioneve komunitare në Evropë, për manaxhimin e krizës së refugjatëve të Ukrainës.



K U A D R I M U N D Ë S U E S L I G J O R M B I A K T I V I T E T I N F I L A N T R O P I K

Partnerët Shqipëri gjatë vitit 2022 hartoi një dokument politikash "*Një mjedis i favorshëm mbi aktivitetin filantropik në Shqipëri*". Ky dokument politikash fokusohet në një analizë krahasimore të vendeve të Evropës Perëndimore, Ballkanit Perëndimor dhe Shqipërisë mbi kuadrin ligjor që rregullon fushat e aktiviteteve të njohura ligjërisht për lehtësira fiskale dhe fashat e stimujve për këto lehtësira për sektorin privat. Përmes këtij dokumenti, Partnerët Shqipëri synon të ofrojë shembuj ligjorë që mund të zbatohen dhe përshtaten në kontekstin shqiptar.

Partnerët Shqipëri gjatë muajit mars organizoi tre takime me përfaqësues të biznesit, dhomave të tregtisë dhe industristrisë dhe bizneseve që kanë politika të përgjegjësive sociale. Qëllimi i këtyre tryezave ishte diskutimi mbi sfidat që sektori privat ndesh, eksperiencia e tyre dhe vlerësimi i lehtësirave tatimore në shërbim të dhurimit. Sipas diskutimeve, ka një nevojë për një rregullim më të mirë ligjor, i cili duhet të marrë në konsideratë zhvillimet në vitet e fundit dhe të zgjerohen aktivitetet e njohura për të përfituar lehtësira tatimore.

TAKIME MBI KUADRIN LIGJOR DHE RREGULLATOR TË AKTIVITETIT FILANTROPIK me sektorin privat

Funded by the European Union

WINGS

PARTNERS FOR CHANGE AND INNOVATION

Tryezë diskutimi

"Mjedisin mundësues ligjor dhe rregullator për zhvillimin e aktivitetit filantropik në vend"

25.03.2022

Kostantina Kerubi

Resource Centre Albania

Shila Xhefa

Brunilda Ili

Arifin Rama

Herqola Spahiu

DIHA DIHA

Nina Kerubi

Resource Centre Albania

Alida Paparisto

Besa Xhumari K...

Sokol Prenga

Besa Xhumari Kredal

Rakip Belishaku

Linda Shomo

Çështjet për diskutimi

Vlerësimi i mjedisit aktual

- Si e vlerësoni mjedisin ligjor aktual lidhur me aktivitetin filantropik?
- A janë lehtësirat fiskale stimuluese për kompanitë për të mbështetur këto aktivitetet?
- Si e vlerësoni procesin e përfitimit të lehtësirave tatimore për aktivitetin e mbështetur? Si e vlerësoni marrëdhënien

Mjedisi mundësues për zhvillimin e aktivitetit filantropik

- Cili do të ishte një mjedisi mundësues për zhvillimin e filantropisë në vend.

**The role of an enabling
environment in fostering**



Philanthropy.

and

Solidarity

in times of crises

**ON
LINE
REGIONAL
FORUM**



Struktura e raportit

- ✦ Raporti fokusohet në dy aspekte kryesore ligjore:
 - Veprimtaritë e pranueshme ligjrisht për përfitime tatimore
 - Fasha e lehtësirave tatimore
- ✦ Raporti fokusohet vetëm tek **aktiviteti filantropik i kompanive**
- ✦ Hulumtim i kuadrit ligjor dhe rregullator mbi filantropinë në Evropë
- ✦ Hulumtim i kuadrit ligjor dhe rregullator në **vëndet e Ballkanit Perëndimor**
- ✦ Hulumtim i kuadrit ligjor dhe rregullator në **Shqipëri**
- ✦ Rekomandime



Më datë 26 maj u organizua forumi rajonal “Roli i një mjedisi mundësues në nxitjen e filantropisë dhe solidaritetit në kohë krizash”. Aktiviteti rajonal mbledhi në një takim virtual rreth 135 përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile, donatorë, përfaqësues të institucioneve publike, sektorit të biznesit, medias, etj.

Diskutimi në forum u fokusua në rolin dhe ndikimin e aktivitetit filantropik gjatë kohës së pandemisë COVID-19, duke theksuar kuadrin ligjor dhe rregullator që mundëson këtë aktivitet, lehtësirat tatimore për individë dhe kompanitë të cilat angazhohen vullnetarisht dhe në terma monetarë për të adresuar nevoja emergjente dhe afatgjata, si dhe tek rëndësia e solidaritetit dhe vullnetarizimit në situata krizash. Mungesa e një regjistri zyrtar mbi dhurimet, trendi rënës i dhurimeve tek organizatat jofitimprurëse dhe kanalizimi i dhurimeve tek institucionet publike si pasojë e efekteve të COVID-19, procedurat burokratike dhe të gjata në kohë për dhuruesit dhe përfituesit e dhurimeve ishin disa nga çështjet e ngritura që kanë nevojë të adresohen nga institucionet publike për të patur një mjedis mundësues për aktivitetin filantropik.



Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate, kati 10,
App. 71 / 73, PO BOX 2418/1
1010 Tirana, Albania